

GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ i Gjykatës Themelore të Prizrenit
tetor 2018

Buletin informativ "Gjykatë e Hapur" * Nr. 12, tetor 2018
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit
www.gjyqesori-rks.org



GJYKATË E HAPUR



PËRMBAJTJE

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Viktimat e krimit dhe të drejtat e tyre.

STORIE E SUKSESIT

Publikimi i aktgjyqimeve në nëntëmujorin e vitit 2018

LAJME

GJYKATA NË MEDIA

Një raport i ri lexohet më shumë se një korrigjim i shkurtër,
të mundohemi të krijojmë raporte pa korrigjime

INTERVISTË E SHKURTË

Arsim Hamzaj (Udhëheqës i Divizionit Civil)

SI TI QASEMI GJYKATËS?

Si caktohen dhe ndahen lëndët?

A e dini se...?!

Kontakttoni Gjykatën Themelore të Prizrenit



FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Të nderuar lexues,

Çështja e viktimave të dhunës dhe krimit në Kosovë është një problem serioz dhe shqetësues, sipas karakterit që ka, dhe është obligim i të gjitha institucioneve që të ndërmarrin të gjitha veprimet në mbrojtje të viktimave dhe realizimin e të drejtave të tyre, sepse është një nga të drejtat themelore të njeriut. Fenomeni i dhunës ndaj viktimave manifestohet në forma të ndryshme si kërcënimi, diskriminimi, përdorimi i forcës, por ndodh që përfundon si krim, pra si vepër penale.

Me qëllim të mbrojtjes ligjore dhe efektive për të gjitha llojet e viktimave të dhunës dhe krimit Kuvendi i Republikës së Kosovës ka nxjerrë ligjet që rregullojnë këtë çështje duke filluar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje, Ligji për familjen, Ligji për barazinë gjinore, Ligji për Policinë e Kosovës, Kodi Penal i Kosovës, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, mirëpo pjesë e legjislacionit tonë janë edhe të gjitha Konventat Evropiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Kur është fjala për dhunën në familje ligji ka paraparë disa forma për mbrojtjen, të cilat mund ti ndërmerr gjykata si urdhër për mbrojtje, urdhër për mbrojtje emergjente, ndërsa policia jashtë orarit të punës në gjykatë mund të marrë urdhër për mbrojtje emergjente të përkohshme, mos respektimi i ndonjërit prej këtyre urdhrave të shqiptuar paraqet vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Në shumicën e rasteve dhuna ndodh ndaj gjinisë femërore, mirëpo ndaj kësaj dukurie negative nuk janë imun as fëmijët, pleqtë, personat e hendikepuar dhe kjo formë e dhunës ndodh kudo në shtëpi, në lokale, restorante, rrugë etj., dhe shprehet në formë të dhunës fizike, emocionale, psikike, seksuale dhe ekonomike.

Është obligim i të gjitha institucioneve që merren me mbrojtjen e viktimave të krimit si është Policia, Prokuroria, Gjykatat, Zyra për mbrojtje dhe ndihmë ndaj viktimave, Qendra për punë sociale, të veprojnë me kujdes dhe urgjencë dhe profesionalizëm, sepse në këtë mënyrë ndikohet në sigurinë fizike të viktimave dhe qasjen e tyre në drejtësi.

Viktimat e krimit kanë të drejtë në mbrojtje dhe strehim, të njoftohen për procedurën para institucioneve policore dhe gjyqësore, të marrin pjesë në gjykim, të trajtohen më respekt dhe dinjitet si dhe të dëmshpërblehen.

Rastet më të shpeshta të krimit ndaj viktimave ndodhin të veprat penale të trafikimit me njerëz, dhunimit, sulmit seksual, keqpërdorimit seksual nën moshën 16 vjeçare, mirëpo falë një bashkëpunimi të mirë ndërmjet Policisë, Njësitit për hetimin e trafikimit me qenie njerëzore, Prokurorisë, Zyrës për mbrojtjen e viktimave, Qendrës për punë sociale si dhe Strehimoreve ku ruhen viktimat e krimit, kemi bërë përpjekje që lëndët e kësaj natyre të trajtohen më prioritet dhe profesionalizëm.

Ligji ka paraparë një formë të mbrojtjes së viktimave të krimit kur vlerësohet se rrezikohet jeta e viktimës dhënia e masës mbrojtëse ose urdhri për anonimitet, mirëpo në këto raste duhet të ruhet identiteti i viktimës.


Po ashtu viktimat duhet të ketë përfaqësues të autorizuar nga fillimi i procedurës penale e sidomos në rastet kur është fëmijë, është në marrëdhënie familjare me të pandehurin, procedura penale zbatohet për vepra penale të trafikimit, ose integritetit seksual, ka çrregullime mendore, ose është i pazotë për tu mbrojtur. Në këtë rast gjykata kur janë në pyetje fëmijët atëherë ka mundësi të angazhojë mbrojtës nga radha e avokatëve.

Kërkohet nga të gjitha institucionet të bashkëpunojnë, sepse vetëm me bashkëpunimin institucional, veprimin në kohë dhe profesionalizëm mundësohet krijimi i një ambienti të qetë dhe krijohet një perceptim i publikut se institucionet për mbrojtjen të viktimave po funksionojnë, po ashtu kërkohet një sensibilizim i opinionit nën ngritjen e vetëdijes së qytetarëve se nuk lejohet asnjë formë e dhunës, diskriminimit dhe krimit. Përkrahja e institucioneve për të gjitha viktimat e çfarëdo natyre qofshin nuk duhet të mungojë.

Ju siguroj se lëndët ku janë në pyetje viktimat e krimit kanë prioritet, dhe do të kenë edhe në të ardhmen, e këtë e mundëson dhe shtimi i numrit të gjyqtarëve, sepse jemi të vetëdijshëm se çdo vonesë në zgjidhjen e tyre mund të ketë pasoja serioze për viktimat të cilat u ekspozohen rreziqeve të natyrave të ndryshme.

STORIE E SUKSESIT

Publikimi i aktgjykimeve të plotfuqishme



Gjykata Themelore e Prizrenit kryeson dukshëm me publikimin e aktgjykimeve të plotfuqishme. Grafika e mësipërme tregon publikimet e aktgjykimeve të plotfuqishme në faqen zyrtare të Gjykatës Themelore të Prizrenit. Në këtë rast, Gjykata Themelore e Prizrenit ka arritur që me punën dhe transparencën e saj të jetë ndër shembujt më pozitiv nga të gjitha Gjykatat e Kosovës edhe për vitin 2018.

Në faqen zyrtare të Gjykatës Themelore të Prizrenit, mund t'i gjeni të publikuara mbi 1435 aktgjykime të plotfuqishme, të anonimizuara në përputhje me nenin 108 dhe 41 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 1, pika 1.15 dhe pika 1.23 të Ligjit nr. 03/1-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 2 të Ligjit Nr. 05/L - 032 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L -199 për Gjykatat, nenin 3 dhe 12 të Ligjit Nr. 03/1-215 për Qasje në Dokumente Publike dhe nenin 1.15 dhe 1.16 të Ligjit Nr.03/1-172 për Mbrojtje e të Dhënave Personale.

Publikimi i aktgjykimeve të plotfuqishme është një ndër mjetet kryesore për promovimin e transparencës gjyqësore përmes qasjes publike. Prandaj, ky grafikon është dëshmia e radhës e përkushtimit maksimal të gjykatës për të jetësuar praktikatat e mira që mundësojnë efikasitet, llogaridhënie, paanshmëri dhe transparencë në punën e saj.

Vlerësimi i qytetarëve mbi shërbimet e Gjykatave Themelore



Prizren – u mbajt takimi mbi hulumtimin që ishte dizajnuar dhe ndërmarr nga Demokraci Plus për të mbledhur pikëpamjet e qytetarëve për performancën e shtatë Gjykatave Themelore të Kosovës. I bërë për nevojat e Programit të USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (JSSP) , hulumtimi ka për qëllim që t’u ofroj informata gjykatave për përmirësim të efikasitetit dhe reputacionit të tyre para qytetarëve. Rezultatet e hulumtimit mund të shërbejnë si një mjet për matjen e cilësisë së shërbimeve në shtat Gjykatat Themelore.

Ky hulumtim i shërben Gjykatave Themelore, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe të gjitha organeve tjera brenda sistemit gjyqësor në Kosovë. Qilimi kryesor është identifikimi i zbrazëtirave në tri fusha dhe përmirësimi i efikasitetit dhe informimit më të mirë për shfrytëzuesit e shërbimeve në gjykatë.

Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit z. Ymer Hoxha, priti në takim Drejtoreshën e Misionit të USAID-it në Kosovë znj. Lisa Magnu, si partner të afërt bashkëpunues me projektin e USAID-it.



Prizren - 06.08.2018, Qëllimi i këtij takimi ishte njohja më për së afërmi me mbarëvajtjen e punës së kësaj gjykate, me të rejat që ka sjellë reformimin i sistemit gjyqësore, për organizimin e trajnimeve të ndryshme për të cilat ka nevojë gjykata e të cilat do të gjejnë mbështetje nga USAID-i, u diskutua për të arriturat dhe sfidat me të cilat ballafaqohet gjykata, rëndësi të veçante në këtë takim Hoxha i kushtoi hapësirës së gjykatës e që u paraqit si shqetësimi pasi po ndikon drejtpërdrejt edhe në suksesin e punës së kësaj gjykate.

Znj. Mango ndër të tjera e vlerësoi lart transparencën e gjykatës në raport me institucionet, shoqëritë civile dhe mediat.

Në pjesën e dytë ata vizituan objektin e gjykatës sallat ku mbahen seancat gjyqësore, dhe si operojnë departamentet brenda gjykatës, u njohën me shërbime të tjera që ofron gjykata për qytetarët e Prizrenit.

Në fund të takimit kryetari Hoxha falënderoj znj. Mango për mbështetje të vazhdueshme që i bëhet gjykatës nga USAID-i si dhe për bashkëpunimin i cili nuk do të mungoj edhe në të ardhmen, si dhe sundimi i ligjit do të jetë prioritet për institucionet e zbatimit të ligjit.

Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan nxënësit e SHMU e klasës së VIII "Mushnikov" nga Mushnikova



Me datën 18.09.2018, në orën 12:00 , Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan nxënësit SHMU e klasës së VIII "Mushnikov" nga Mushnikova.

Vizita kishte për qëllim njohjen më të afërmi të punës që bëjnë kjo gjykatë dhe me punën e gjyqtarëve brenda departamenteve të ndryshme.

Nxënësit u pritën në njërin nga sallat e gjykimit nga Kryetari i kësaj gjykate z. Ymer Hoxha, ku u prezantua struktura e gjykatës, punën që bëjnë gjykata, sfidat dhe bashkëpunimin e gjykatës me qytetarët, mënyrën e komunikimit dhe mjetet e zhvilluara për krijimin e një lidhje më të mirë me publikun ku edhe vazhduan me diskutimet e hapura. Ndër të tjera u diskutua për të rejat që ka sjell reformimi i sistemit gjyqësor, mundësit për takime direkt me Kryetarin e Gjykatës dhe pjesëmarrjen në seanca gjyqësore të hapura për publikun.

Në pjesën e dytë të takimit, nxënësit patën mundësi të njihen me objektin e gjykatës, me punën që bëjnë secila zyre, me sallat e seancave gjyqësore, dhomën e dëshmitarëve dhe materialet informuese të gjykatës.

Gjykata do të vazhdoi traditën e bashkëpunimit me qytetarët me shkollat e qytetit dhe të rajonit.

Paqeruajtësit Gjerman-Ekipet për Ndërlidhje dhe Monitorim LMT të KFOR-it vizituan Gjykatën Themelore të Prizrenit



Me datën 19.09.2018, në orën 13:00 , Paqeruajtësit Gjerman – Ekipet për ndërlidhje dhe Monitorim LMT të KFOR –it, Capt. R.Jaeger dhe 2LT L.Sutter, me seli në Prizren, vizituan Gjykatën Themelore të Prizrenit me ç ‘rast u pritën nga Zyrtarja për Informim Publik e kësaj gjykate Afërdita Kicaj.

Qëllimi i këtij takimi ishte njohja më për së afërmi me mbarëvajtjen e punës së kësaj gjykate, me seancat që procedohen në gjykatë, bashkëpunimin me institucionet e tjera të drejtësisë, transparencën e gjykatës, u njoftuan me punën e zyrës për informim publik, qasjen e qytetarëve brenda në gjykatë si dhe u pajisen me buletinin informativ “Gjykatë e Hapur” në të cilin përfshihen aktivitetet e gjykatës.

Misioni i OSBE-së në Kosovë organizoi një punëtori mbi kualifikimin e drejtë të veprave penale në Prizren



Misioni i OSBE-së në Kosovë organizoi një punëtori mbi kualifikimin e drejtë të veprave penale në Prizren. Gjykatësit e Gjykatës Themelore të Prizrenit, Kryeprokurori i Prizrenit si dhe Drejtori i Policisë Rajonale të Prizrenit ishin në mesin e të pranishmëve. Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan se policia dhe prokuroria kanë për detyrë të bashkëpunojnë në hetimin e krimit duke i shqyrtuar faktet e rasteve me kujdes dhe me përkushtim maksimal profesional.

Nga kjo punëtori dolën përfundime dhe rekomandime konkrete që kanë për qëllim përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve relevante të sundimit të ligjit dhe sigurimin e përpjekjeve të përbashkëta për të kryer në mënyrë efikase procedurat penale gjithmonë duke i mbrojtur të drejtat e palëve të përfshira.

Pjesëmarrës ishin gjithsej 24, në mesin e të cilëve kishte gjyqtarë, prokurorë dhe hetues të policisë.

GJYKATA NË MEDIA

Një raport i ri lexohet më shumë se një korrigjim i shkurtër, të mundohemi të krijojmë raporte pa korrigjime

Gjykata ka reflektuar në mënyrë pozitive duke qenë bashkëpunuese dhe ka një nivel të mirë të transparencës. Gjatë nëntëmuorit të vitit 2018 – Zyra për Informim e Gjykatës Themelore të Prizrenit ka lëshuar 42 komunikata të cilat kanë pasur për qëllim të njoftojnë publikun mbi rastet e paraburgimeve dhe shqiptimin e dënimeve në rastet gjyqësore, njoftime për vizitat në gjykatë, takimet e punës dhe tryezat, si dhe ka publikuar mbi 1435 aktgjykime të plotfuqishme.



Si gjykata e vetme në Kosovë, Zyra për Informim me mjaft sukses po e publikon numrin e dymbëdhjetë (12) të Buletinit Informativ “Gjykatë e Hapur”, e cila është një dritare e transparencës së punës së Gjykatës Themelore të Prizrenit, që synon fuqizimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në punën e Gjykatës në veçanti. Jemi tejet të motivuar që këtë mjet të transparencës po vazhdojmë ta mbajmë gjallë.

Komunikatat për media të gjykatës janë paraqitur në të gjitha mediat lokale, të cilat kanë transmetuar në mjetet e tyre të informimit në nivel shumë të kënaqshëm ngjarjet dhe materialet e shpërndara nga Gjykata. Ju falënderojmë për kontributin e juaj për një gjykatë të hapur dhe transparente.

INTERVISTË E SHKURTË

Transparenca e gjykatave, është kusht themelor për efikasitetin dhe besimin e publikut në punën e gjykatave.



Arsim Hamzaj - Udhëheqës i Divizionit Civil

1. Si udhëheqësi i departamentit të përgjithshëm - divizionit civil cilat janë sfidat me të cilat përballeni në punën tuaj si gjyqtarë dhe sa keni arritur që ta zvogëloni numrin e lëndëve në gjykatë?

Sfidat me të cilat përballlet departamenti i përgjithshëm - divizioni civil janë ato me të cilat përballen edhe departamentet tjera siç janë: vonesat në procedimin e çështjeve, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës ku në këtë divizion deri në fund të vitit 2017, kanë punuar 8 gjyqtar, ndërsa që njëri prej tyre në fund të viti 2017 ka shkuar në pension, ndërsa dy tjerë janë avancuar në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e që pozitat e tyre deri më tani nuk janë plotësuar, andaj kemi rritjen e numrit të lëndëve të pa kryera në këtë divizion, ku secili gjyqtar në fundit të vitit 2017 në raportin e tij vjetor si lëndë të pa kryera kanë raportuar përafërsisht nga 150 lëndë të mbetura për vitin 2018, ndërsa deri në muajin tetor 2018, ky numër është rritur dhe secili gjyqtar ka në punë përafërsisht nga 350 lëndë. Po ashtu si sfidë tjetër është edhe mungesa e bashkëpunëtor profesional të cilët nuk janë të mjaftueshëm për numrin e gjyqtarëve të cilët i ka kjo gjykatë.

2. Sa transparente është gjykata përball publikut në punën e saj ?

Transparenca e gjykatave, është kusht themelor për efikasitetin dhe besimin e publikut në punën e gjykatave. Mendojë se Gjykata Themelore në Prizren, është mjaftë transparente në punën e saj duke filluar nga ndarja e lëndëve të cilat ndahen me short, pastaj publicitetin e gjykimeve -

seancave të cilat publikohen rregullisht në tabelën elektronike, e cila gjendet brenda objektit të gjykatës, pastaj publikimi i vendimeve dhe informacioneve tjera në faqen zyrtare të internetit të gjykatës. Po ashtu sa i përket transparencës në gjykatë ekziston edhe zyra e komunikimit me publikun e cila vazhdimisht jep informacione për publikun dhe mediat e ndryshme në lidhje me punën e gjykatës, andaj mendoj se këto e bëjnë gjykatën mjaft transparente në punën e saj.

3. Dhuna në familje është një nga çështjet mjaft të ndjeshme në shoqëri, sa kanë prioritet këto lëndë në zgjidhjen e tyre dhe a është në rritje numri i këtyre lëndëve në gjykatë?

Dhuna në familje, është një dukuri mjaft e shfaqur në shoqërinë kosovare, ku viktimat e dhunës janë në të shumtën e rasteve gjinia femërore, mirëpo ka edhe raste kur viktimë është edhe gjinia mashkullore. Fatkeqësisht statistikat tregojnë se dhuna në familje vazhdimisht është në rritje nga viti në vit. Me qëllim të luftimit të kësaj dukurie dhe mbrojtjes sa më të mirë të viktimave të dhunës në familje edhe në Kosovë është punuar në rregullimin e infrastrukturën ligjore për të mbrojtur dhe parandaluar dhunën në të ardhmen, ku fillimisht është nxjerrë Rregullorja e UNMIK nr.2003/12 për mbrojtjen nga dhuna në familje, e pas kësaj është nxjerr edhe ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje Nr.03/L-182. Këto raste në gjykatë kanë përparësi dhe trajtohen si raste urgjente konform dispozitave ligjore të parapara në ligjin e lartcekur, pasi që gjykata duhet të vendos brenda afatit 15 ditor pas pranimit të kërkesës. Në Gjykatën Themelore në Prizren me qëllim të kryerjes sa më efikase të këtyre rasteve që nga viti 2013 me këto raste është i caktuar një gjyqtarë i profilizuar për këto raste.

4. Cilat janë fazat e shqyrtimit gjyqësor në procedurën civile kontestimore dhe ku qëndron dallimi me procedurat e tjera gjyqësore?

Procedura kontestimore zhvillohet sipas rregullave të cilat janë paraparë në ligjin për procedurën kontestimore, në të cilën janë të parapara disa faza nëpër të cilat kalon procedura. Menjëherë pasi të arrij padia në gjykatë, gjykata i fillon përgatitjet për shqyrtimin kryesor të çështjes ku merr një mori të vendimeve procedurale siç janë: ekzaminimi paraprak i padisë, dërgimi i padisë palës së paditur për dhënien e përgjigjes në padi, mbajtja e seancës përgatitore dhe caktimi i seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes. Pra me një fjalë fazat në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor në procedurën kontestimore janë: 1. shqyrtimi paraprak i padisë, 2. dërgimi i padisë për përgjigje në padi, 3. Seanca përgatitore dhe 4. Shqyrtimi kryesor.

5. A ka një afat të caktuar kohorë brenda të cilit një gjyqtar mund të sjell një vendim përfundimtar për një çështje të cilën e shqyrton?

Siç u cek edhe më lartë rregullat e procedurës kontestimore janë të parapara me ligjin për procedurën kontestimore në të cilën janë të parapara edhe afatet brenda të cilëve duhet të vendoset për çështjen e ngritur në padi. Në afatin prej 15 dite pas paraqitjes së padisë, gjykata ia dërgon të paditurit padinë për përgjigje se bashku me shkresat e bashkangjitura të padisë, i cili në afatin prej 15 ditësh ka për detyrë që të përgjigjet me shkrim në padi e pastaj gjykata pasi të arrijë përgjigje në padi apo pasi të kalojë afati për përgjigje në padi e cakton seancën përgatitore në afatin prej 30 dite, dhe pas përfundimit të seancës përgatitore menjëherë e cakton seancën e shqyrtimit kryesor në afatin prej 30 dite. Me qëllim të mos zvarritjes të panevojshme të procedurës me ligj është paraparë që shtyrja e seancave të mos bëhet më gjatë se 30 ditë e po ashtu gjykata ka për detyrë që 7 dite që para fillimit të seancës të bëjë verifikimin nëse janë plotësuar kushtet për mbajtjen e shqyrtimit. Mirëpo në praktikë për shkak të numrit të madh të lëndëve të grumbulluara nëpër gjykata dhe numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve, është shumë vështirë që gjykatat ti përmbahen në tërësi këtyre afateve ligjore për përfundimin e një procesi gjyqësor.

SI T'I QASEMI GJYKATES?

Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.



Të gjitha seancat gjyqësore do të jenë të hapura për publikun përpos nëse ligji e përcakton ndryshe.



A e dimi se...?!

(Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje)

Dhunë në familje - një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:

1.2.1. përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;

1.2.2. çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;

1.2.3. shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;

1.2.4. sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;

1.2.5. ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;

1.2.6. përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përruljes së personit tjetër;

1.2.7. marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;

1.2.8. kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;

1.2.9. dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;

1.2.10. vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike.





Kontaktioni Gjykatën Themelore të Prizrenit

**Zyra e Administratës
Tel: +381 (0) 29/244 122**

**Adresa:
Gjykata Themelore
e Prizrenit**

Rr. "Ibrahim Lutfiu",
p.n. Prizren, Kosovë

**Vizito:
www.gjyqesori-rks.org**



**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU
PRIZREN TEMEL MAHKEMESI
BASIC COURT OF PRIZREN**

GJYKATË E HAPUR
Buletin informativ i Gjykatës Themelore të Prizrenit
tetor 2018

Buletin informativ "Gjykatë e Hapur" * Nr. 12, tetor 2018
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit
www.gjyqesori-rks.org